



**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ** - Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Alban Beqiri, me sekretaren juridike Donjeta Elezi, në çështjen juridike të paditëses Posta dhe Telekom i Kosovës – në Prishtinë, të cilën e përfaqëson [REDAKTUAR] me autorizim, kundër të paditurit [REDAKTUAR] nga Ferizaj Rr.” [REDAKTUAR] [REDAKTUAR]”, për pagimin e borxhit, vlera e kontestit 375,63 €, pas seancës publike të mbajtur më 08.12.2015, në prezencën e përfaqësueses së paditëses dhe në mungesë të të paditurit, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** kërkesë padia e paditëses [REDAKTUAR] në Prishtinë, kundër të paditurit [REDAKTUAR], nga [REDAKTUAR] Rr.” [REDAKTUAR]”, për pagesën e borxhit në shumë prej 375.63 €, në emër të shfrytëzimit të telefonisë fikse, **SI E PA BAZUAR.**

**OBLIGOHET** paditësja që në emër të taksës gjyqësore ta paguaj shumën prej 15 euro në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

### **A r s y e t i m i**

Gjykata sipas udhëzimeve nga ana e Gjykatës së Apelit të Kosovës me aktvendimin CA.nr.985/2013 dt.22.04.2015 me të cilin e ka prishë aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.189/2008 dt.17.01.2013, në të cilin aktvendim është konstatuar se gjykata e shkallës së parë nuk ka vendosur me pretendimet e të paditurit në lidhje me parashkrimin e kërkesë padisë.

Gjykata pas pranimit të aktvendimit nga ana e Gjykatës së Apelit të Kosovës të njëjtin e ka analizuar dhe brenda afatit ligjor, e ka caktuar seancën e shqyrtimit me datën 08.12.2015, ku përfaqësuesja e paditëses është deklaruar:

Ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesë padisë, duke theksuar se paditësja ka nënshkruar me të paditurin me dt.05.02.2007, kontratën për riprogramin e borxhit me

kiste për shfrytëzimin e telefonisë fikse dhe atë për numërin e telefonit 21-405, ku edhe për kundër nënshkrimit të kësaj kontrate i padituri nuk e ka përmbushur.

Sa i përket aktvendimit të Gjykatës së apelit në lidhje me parashkrimin e kërkesë padisë ka theksuar se e kundërshton një qëndrim të tillë dhe se kërkesë padia nuk është parashkruar

I ka propozuar gjykatës që ta aprovon kërkesë padinë e paditëses si të bazuar, si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

I padituri në seancën e datës 08.12.2015, ka munguar edhe pse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt siç shihet nga flet kthesa e Gjykatës ku ftesën e ka pranuar me datë 16.11.2015, shtyrjen nuk e ka kërkuar dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, andaj Gjykata seancën e ka mbajtur në mungesë të autorizuarit të paditurës konform nenit 423 par. 4 të LPK-së.

I padituri ka deklaruar se e ka kundërshtuar kërkesë padinë e paditëses si të pa bazuar, faturat të cilat gjinden në shkresat e lëndës nuk i ka pranuar asnjë nga ana e paditëses si dhe duke marr parasysh datën e nënshkrimit të kontratës për rimbursim të dëmit dhe datë e paraqitjes së padisë shihet se ka kaluar mbi një vite dhe e njëjta është parashkruar.

Ka kërkuar nga ana e gjykatës që kërkesë padinë e paditëses ta refuzon si të pa bazuar.

Gjykata në këtë çështje bëri administrimin e provave duke bërë shqimin dhe leximin e tyre: Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.189/28 i dt.17.01.2013, ankesa e të paditurit e dt.28.01.2013, aktvendimi i gjykatës së apelit të Kosovës CA.nr.985/13 i dt.22.04.2015.

Gjykata pas vlerësimit të provave të administruara në kuptim të nenit 8 të LPK-së gjeti se kërkesë padia e paditëses është e pa bazuar.

Gjykata duke u bazuar në provat e administruara konstatoi se ka ekzistuar marrëdhënia juridike në mes paditëse dhe të paditurit për shfrytëzimin e telefonis fikse nga i cili shfrytëzim i padituri nuk ia ka paguar paditëses shumën e borzhit prej 375.63€.

Nga provat e administruara shihte se palët ndërgjyqëse kanë lidhur kontratë për rimbursim të borxhit me dt.05.02.2007, kurse propozimi, i cili tani konsiderohet padi është paraqitur në gjykatë me dt.15.05.2008.

Andaj siq shihet kjo duke u bazuar në dispozitat e nenit 360 par.1 pika 1 të LMD-së, kërkesë padia e paditëses është parashkruar dhe të njëjtën e ka refuzuar dhe ka vebndosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që nga data e nënshkrimit të kontratës në lidhje me pagesën e telefonisë fikse deri me datën e paraqitjes së padisë kanë kaluar mbi një vite.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e mbështeti në nen.452.1 të LPK-së, obligohet paditësja që ta paguanë shpenzimet e procedurës për përpilim të aktgjykimit shumë prej 15€.

Nga sa u tha më lart u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,  
C.nr. 306/15 më datë 08.12.2015**



Gjyqtari,  
Pan Beqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 dite, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinës, përmes kësaj Gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KO...  
VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ I UROŠEVAC

më /  
Data 12.01.2016